

GJEODETI

Botim i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë

Editorial nga Julian Ismaili

Dita e Gjeodetëve të Shqipërisë

CLGE dhe EGoS vizitojnë Shqipërinë

**Mbi hartimin e
“Ligjit të Gjeodetit”
dhe parashikimi i krijimit
të “Dhomës Profesionale”**
Nga: Bledi Stefa

Myfit Guxholli
Një jetë kushtuar profesionit

Belgium Surveyors in Albania
Union des Géomètres de Mons

Tiranë 2013





Sjell në tregun shqiptar të gjithë llojet e GPS,


- GPS Dore,
- Navigator makine,
- Gps peshkimi,
- Ora gps,
- Harta gjeopolitike
- Harta te navigueshme,
- Kalibrim
- Vendasje koordinatash

GARMIN
AUTHORIZED DEALER



GJITHASHTU GEOTRIM SJELL NE TREG:

- BUSULLA GJEOLGJIKE
- BUSULLA PER MINIERA
- BUSULLA TE VARURA



GEOTRIM

SURVEYING ~ CONSTRUCTION ~ NIKON-TRIMBLE ~ GARMIN



Adresa: Rr. Lord Bajron, Vila Nr.1,
(Kryqëzimi kryesor i Laprakës)
Laprakë, Tiranë,

Tel: +35542257548, Mob: +355682055616
E-mail: geotrim.al@gmail.com; contact@geotrim.al
Web: www.geotrim.al; www.trimble.com

Këshilli Konsultativ i Revistës Gjeodeti

- | | | |
|------------------------------------|---------------------------------|-----------------------------------|
| 1. Bledi Stefa, Kryetar | 10. Alban Hasa, Student | 19. Fatmir Ejupi, Pushteti Vendor |
| 2. Julian Ismaili, Belgjikë | 11. Ylber Shabani, Preshevë | 20. Petrit Jani, Pushteti Vendor |
| 3. Jonathan Albert, Belgjikë | 12. Besnik Hysaj, Geo Nord | 21. Alban Suku, Student |
| 4. Murat Hoxha, Kosovë | 13. Edison Sinanaj, Gjeo Sky | 22. Azbi Arapi, Geotrim L.t.d |
| 5. Murat Meha, Kosovë | 14. Kostandin Qirjazi, GentAlba | 23. Perparim Ndoi, Land & Co |
| 6. Romeo Nazarko, Akkp | 15. Anri Saja, Pushteti Vendor | 24. Jak Suli, Geomatica Sh. p. k |
| 7. Gëzim Gjata, Dep i Gjeodezisë | 16. Shabedin Toska, Strugë | 25. Xhevahir Mustafa, Gjeokonsult |
| 8. Sokol Allaraj, Dep i Gjeodezisë | 17. Lorenc Zani, Lorenzo & Co | 26. Altin Pojani, Inxhinier |
| 9. Gëzim Bisha, Dep i Gjeodezisë | 18. Erina Palushi, Kesh Sh. A | |



Carlson
Europe ■ Middle East ■ Africa

9-10 NOVEMBER 2012

BELGIUM SURVEYORS IN ALBANIA UNION DES GÉOMÈTRES DE MONS

Me ftesë të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë, në datat 9 dhe 10 nëntor 2012, Unioni Belgë i Gjeodetëve të Monsit vizitoi Shqipërinë. Qëllimi i vizitës së tyre ishte shkëmbimi i eksperiencave profesionale në lidhje me administrimin dhe menaxhimin e tokës. Presidenti i UGEM Z. Jonathan Alber, mik i Shqipërisë dhe i Shoqatës së Gjeodetëve ishte përkrahësi më i madh i kësaj vizite i cili, mbas përpjekjeve arriti të sjell në Shqipëri 12 kolegët e tij, të gjithë të motivuar për të dhënë sado pak mbështetjen e tyre për zhvillimin dhe integrimin profesional të kolegëve Shqiptar.

Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë kishte marr të gjitha masat për një organizim perfekt të kësaj vizite si dhe, kish ngritur një grup të posaçëm për pritjen e miqëve nga Belgjika. Në përbërjen e Grupit ishin Kryetari i SHGJSH-së Z. Bledi Stefa, Përfaqësuesi i SHGJSH-së për Europën Z. Julian Ismaili dhe Drejtuesi i Strukturës Young Surveyors Z. Alban Suku.



Në datën 9 nëntor 2012 SHGJSH organizoi seminarin me teme “Administrimi dhe Menaxhimi i Tokës”, Roli i Gjeodetit në reformën e pronësisë si dhe shkëmbimi i eksperiencave midis dy shteteve. Seminari u organizua në formën e një tryeze të rrumbullakët ku të ftuar ishin rreth 40 persona, përfaqësues të Institucioneve Shtetërore, Kompanive Private, Gjeodet të Liçensuar, etj. Gjatë zhvillimit të seminarit u diskutuan tema shumë të rëndësishme që prekin realitetin e profesionit të Gjeodetit në Shqipëri, si:

- Implementimi i koordinatave
- Zhvillimi i Teknologjisë
- Sistemi Lokal i Pozicionimit
- Statusi i Gjeodetit
- Krijimi i Dhomës së Gjeodetëve
- Taksimi
- Kadastra 3D
- Etj





Në datën 10 nëntor 2012, u mbajt konferenca me po të njëjtën temë ku të përfshirë ishin jo vetëm përfaqësues nga institucionet më të rëndësishme në vend por edhe anëtar të Strukturës Young Surveyors, anëtar të SHGJSH-së, Pedagogë nga Departamenti i Gjeodezisë FIN etj.

Z. Bledi Stefa Kryetar i SHGJSH-së, përshëndeti të pranishmit dhe ftoi të deklaronte zyrtarisht të hapur konferencën, Z. Jonathan Albert President i UGEM. Më pas fjalën përshëndetëse e mori Sekretari i Unionit Belgë të Gjeodetëve të Monsit Z. José Vanderwhale. Gjithashtu të pranishmit u përshëndetën nga Z. Julian Ismaili përfaqësues i SHGJSH-së për Europën si dhe Z. Alban Suku Drejtues i Strukturës Young Surveyors. Më pas zhvillimi i konferencës pasoi me prezantime të ndryshme profesionale kryesisht me tematik pronësinë, administrimin e tokave dhe menaxhimin e tyre.

Unionit Belgë të Gjeodetëve të Monsit ju dha titulli Anëtar Nderi i SHGJSH-së si dhe Z. Jonathan Albert ju paraqit çertifikata e falenderimit për kontribute të veçanta në fushën e Gjeodezisë. Çertifikatë falenderimi morën gjithashtu, Z. Julian Ismaili dhe Z. Alban Suku.

22 Janar 2012

DITA E GJEODETËVE TË SHQIPËRISË

Nën kujdesin e Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë si dhe me ndihmën e Strukturës Young Surveyors, u zhvillua Dita e Gjeodetëve të Shqipërisë. Në këtë ditë të veçantë të Gjeodetëve Shqiptar, morën pjesë figura të njohura të profesionit por edhe politikës Shqiptare. Nderuan me pjesmarrjen e tyre përfaqësuesit e Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës të cilët kryesoheshin prej Kryetarit Z. Murat Hoxha si dhe prej ish-kryetarit, njëherazi Anëtar Nderi i SHGJSH-së Z.



Abdurrahman Kuleta. Gjithashtu, morën pjesë edhe të ftuar nga Shoqata e Vlerësuesëve të Pasurive të Paluajtëshme ku, Znj. Vjollca Bazaiti, Anëtare e Bordit Drejtues të SVP përshendeti me fjalën e saj. Përshëndetje patën edhe Z. Ilir Qerfozi, Drejtor në MPPT i cili solli në vëmendje të të pranishmëve Projektligjin mbi Krijimin e Urdhërit të Inxhinierit.

Vlen të theksohet vizita e Z. Ernest Noka, Zëvendësministër i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit i cili bëri edhe hapjen e këtij evenimenti. Në fjalën e tij Z. Noka, mbasi falenderoi organizatorët për ftesën e bërë, vlerësoi rëndësinë e Gjeodetit në projekte të ndryshme si dhe nuk la pa përmendur shumë prej personaliteteve të shquara të këtij profesioni.





Në fund të fjalës së tij, Zëvendësministrit ju dhurua një kopje e Revistës Gjeodeti si dhe një certifikatë falenderimi për suportin e dhënë Gjeodetëve Shqipëtarë.

Në vijim të programit, fjalën e morën shumë personalitete të Gjeodezisë mbarëshqiptare si dhe mbështetësit më potencial të SHGJSH-së. Mund të përmendim Profesorët. Myslym Pashaj, Gëzim Bisha, Hiqmet Gonxhe, Z. Azbi Arapi, Z. Jak Suli, Z. Përparim Ndoi, Z. Ylber Shabani etj.



Në këtë ditë u nderua me Titullin Anëtar Nderi i SHGJSH-së Prof. Myfit Guxholli i cili dallohet për kontributin e tij dhënë në këtë profesion si dhe me edukimin e brezave të rinj për mbi 25 vite punë akademike. Data 22 Janar 2012 ishte data në të cilën doli në treg revista më e re me emrin “Gjeodeti” si i vetmi buletin informues mbi Gjeodezinë në Shqipëri.



28 Nëntor 2012

GJEODETËT MBLIDHEN PËR TË FESTUAR 100 VJETORIN E PAVARSISË

Me inisiativë të disa studentëve, pjesë e strukturës Young Surveyors të cilët studiojnë në Departamentin e Gjeodezisë, pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit u organizua një drekë festive me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë të Shtetit Shqiptar. Njoftimi u bë publik për të gjithë personat që kishin dëshirë të ishin pjesë e kësaj feste. Pjesa më e madhe e strukturave profesionale iu bashkangjitë kësaj nisme dhe pranuan që të ishin present në Resortin Te Stela i cili ishte përcaktuar për të qënë vend takimi i radhës.

Nga Departamenti i Gjeodezisë mori pjesë Dr. Gëzim Gjata, Përgjegjës i këtij departmenti i cili shoqërohej dhe nga pedagogë të tjerë. Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë që në momentin e parë të marrjes së njoftimit, përgëzoi organizatorët dhe iu bashkua aktivitetit pa hezitim. Nga Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë mori pjesë Kryetari i saj, Z. Bledi Stefa dhe Drejtuesi i Strukturës Young Surveyors Z. Alban Suku së bashku me një pjesë të mirë të anëtarëve të kësaj strukture. Pjesëmarrës kishte edhe nga Gjeodetët e

Liçensuar si dhe biznesi privat. Festimi i 100 Vjetorit të Pavarësisë të Shtetit Shqiptar shkoi më së miri. Në fund të pranishmit realizuan disa fotografi në shenjë kujtimi për kryefestën e Shqipërisë.



22 Qershor 2012

BORDI DREJTUES I “THE COUNCIL OF EUROPEAN GEODETIC SURVEYORS” VIZITON SHQIPËRINË



Në datën 22. 06. 2012, Bordi Drejtues i Këshillit të Gjeodetëve të Europës (CLGE) vizitoi Shqipërinë dhe Tiranën. Të iniciuar nga kontaktet e shpeshta me Shoqatën e Gjeodetëve të Shqipërisë, si dhe me propozimin e Z. Jean-Yves Pirlot, President i CLGE-së, bordi drejtues vendosi që takimin e tyre të rradhës ta zhvillojnë në Shqipëri.

Kolegët tanë Gjeodetë të CLGE-së
përfaqësoheshin prej:

Z. Jean- Yves Pirlot,
President i CLGE, nga Belgjika
Z. Leiv Bjarte Mjos,
Zv/ President i CLGE, nga Norvegjia
Z. Rudolph Kolbe,
ish Zv/ President i CLGE, nga Austria
Z. Pedro Ortiz,
Zv/ President i CLGE, nga Spanja
Z. Danko Markovinovic,
Zv/ President i CLGE, nga Kroacia
Znj. Michelle Camilleri,
Sekretare e Përgjithshme e CLGE,
nga Malta
Z. Dieter Seitz,
Thesarit i CLGE, nga Gjermania
Znj. Ann Pirlot Vandaele,
Përfaqësuese e CLGE, nga Belgjika





Gjithashtu e pranishme ishte **Znj. Benedicte Fournier Schmitt**, përfaqësuese e strukturave të ngjashme profesionale Franceze njëherazi e deleguar edhe nga Komisioni European për të bërë të mundur përcjelljen e të gjitha diskutimeve në instancat më të larta të Bashkimit European.

Qëndrimi i tyre në Tiranë ishte dy ditë. Ditën e parë Bordi Drejtues i CLGE zhvilloi mbledhjen e tyre ku të pranishëm ishin edhe strukturat e Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë, të përfaqësuara nga Z. Bledi Stefa Kry-

etar i SHGJSH-së, Z. Julian Ismaili përfaqësues i SHGJSH-së për Europën si dhe Z. Alban Suku drejtues i Strukturës Young Surveyors.

Në ditën e dytë të qëndrimit të tyre Bordi i CLGE mbajti një seminar të përbashkët të organizuar nga Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë ku u diskutua progresi dhe problematikat aktuale të Gjeodetëve Shqiptar. Të pranishëm në seminar ishin përfaqësues të biznesit në fushën e gjeodezisë, strukturat akademike, Gjeodetët e Liçensuar si dhe një përfaqësi e Gjeodetëve të

së Ardhmes. Gjatë seminarit të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga institucionet më të larta shtetërore, nga pushteti qendror dhe ai lokal.

Pak më poshtë janë temat e diskutuara gjatë aktiviteteve respektive:

- Politikat Gjeodezike Europiane.
- Situata aktuale e Gjeodezisë Shqipëtare dhe prespektiva e saj.
- Raportet profesionale gjeodezike ndërmjet Shqipërisë Europës dhe Botës.



26 Janar 2013

FESTOHET NË TIRANË ME PËRMASA MADHËSHTORE “DITA E GJEODETIT”

Siç e dimë të gjithë, tashmë Dita e Gjeodetit është një festë e bukur jo vetëm për Gjeodetët Shqiptar por edhe si një shëmbull i vlerave dhe cilësive që përcjellë kjo ditë, tek pothuajse të gjitha grupet e tjera të interesit. Me një numër të konsiderueshëm pjesmarrësish, ndonse më tepër se 400 vetë, festohet në Resortin Te Stela dita më e veçantë e Gjeodetëve.

Organizator kryesor i festimit të Ditës së Gjeodetit,



është Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë e cila, në bashkëpunim me Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës si dhe me përfaqësuesit e trevave të tjera nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva, dhurojnë në këtë ditë kaq të veçantë cilësi, vlera dhe harmoni të shkëlqyer që e karakterizon këtë profesion kaq fisnik.

Pjesë e organizimit të eventit janë gjithashtu edhe institucionet më në zë ku Gjeodeti ushtron profesionin e tij. Ishin pothuajse 10 institucione shtetërore të cilët përfaqësoheshin nga një numër i konsiderueshëm

profesionistësh, ku gjithsejili prej tyre vinte me një eksperiencë të re.

Gjithashtu, festimi i Ditës së Gjeodetit gjen mbështetjen edhe të strukturave akademike në vend por edhe jashtë tij. Albanian Young Surveyors ose Gjeodetët e së Ardhmes, janë kthyer tashmë në një pjesë të pandashme e të gjitha aktiviteteve që SHGJSH organizon. Ata me punën e tyre jo vetëm që mbështesin shoqatën por, krijojnë lidhje, kontakte dhe shkëmbim informacioni me të gjitha strukturat që marrin pjesë në aktivitete. Me plotë bindje themi që SHGJSH u ka krijuar atyre të gjithë luksin për të patur një të ardhme mëse të qartë, në atë shkollim që ata janë duke investuar.

E veçanta e kësaj dite ishte se të pranishëm kishim edhe përfaqësues nga shoqatat si motra konkretisht, Shoqatën Shqipëtare të Inxhinierëve Konsulent SHOSHIK dhe Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë. Të dy presidentët e shoqatave respektive, Z. Faruk Kaba dhe Z. Agron





Jano, vlerësuan punën dhe rëndësinë e Gjeodetit si dhe përcollën mesazhin e bashkëpunimit në favor të mbrojtjes së interesave tona të përbashkëta. Fjalën e hapjes së eventit e bëri Kryetari i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë Z. Bledi Stefa i cili falenderoi të pranishmit si dhe ju uroj Gëzuar Ditën e Gjeodetit, Ditën e Gjeodezisë. Më tej Z. Stefa vazhdoi duke falenderuar të gjithë ata persona të cilët me punën e tyre kishin kontribuar sado pak që ky profesion të ecë përpara drejt rrugës së zhvillimit. Të gjithë mbështetësit e SHGJSH-së morën një falenderim të veçantë për punën dhe kontributin e tyre dhënë në favor të shoqatës. Ndër të tjera, ju dedikua një përshëndetje speciale të gjitha trevave të pranishme në sallë. Z. Bledi Stefa, theksoi në fjalën e tij aderimin e vendit në strukturat europiane si dhe funksionimin e profesionit të Gjeodetit ashtu sikurse është edhe në vendet më të zhvilluara të botës. Rëndësi në fjalën e tij patën edhe probleme me tematika të ndryshme, por më kryesorja ishte thirrja për vendosjen e standarteve, unifikimin e tyre dhe krijimin e strukturave të specializuara si, hartimi i deontologjisë së Gjeodetit (hartimi i ligjit të Gjeodetit) si dhe krijimi i Dhomës së Gjeodetëve të Liçensuar.



Vlen të theksohet fakti i bashkëpunimit me Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës si dhe me çdo anëtar të saj, të cilët kësaj rradhe përfaqësoheshin nga Kryetari i tyre Z. Murat Hoxha. Në fjalën e tij Z. Hoxha falenderoi gjithashtu SHGJSH-në si dhe vuri theksin në zhvillimin dhe përparimin që SHGJSH ka pasur vitet e fundit. Z. Hoxha ju uroj të gjithë Gjeodetëve gëzuar festën dhe u bëri thirrje për bashkëpunim me strukturat tona respektive.

Pothuajse në çdo aktivitet profesional nuk mungon Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Kryeshefi i saj Z. Murat Meha, njëherazi Anëtar Nderi i SHGJSH-së. Treva e Malit të Zi u përfaqësua nga Z. Daut Bejta i shoqëruar edhe nga kolegë të tjerë Gjeodet Shqiptar



të Malit të Zi. Të pranishëm ishin edhe Gjeodet të trevës së Preshevës. Gjeodetët Shqiptar të Maqedonisë ishin të përfaqësuar nga Z. Jakup Fetai inxhinier me eksperiencë të gjatë pune, njëherazi Anëtar i Bordit Drejtues të Dhomës së Gjeodetëve të Maqedonisë. Z. Fetai nderoi të pranishmit me një prezantim tepër frutdhënës në kuadër të nismës së SHGJSH-së, për themelimin e Dhomës së Gjeodetëve. Ai solli eksperiencën e funksionimit të Dhomës së Gjeodetëve të Liçensuar të Maqedonisë.



Miratimi i Kodit të Etikës së Gjeodetit

Në datën 26 Janar 2013, në konsultim nga dy grupet më të mëdha të interes, SHGJSH dhe SHGJK u paraqit për miratim Kodi i Etikës së Gjeodetit. Ky kod është mjaft i rëndësishëm pasi jo vetëm që e mbron Gjeodetin por e nxitë atë në kryerjen e një punë sa më profesionale, qasjen me ç'do inovacion si dhe nxitjen me zgjerimin e kapaciteteve profesionale.



PUNIME TOPOGJEODEZIKE "GJEODETIKA 2010"



e-mail: gjeodetika_2010@yahoo.com

Pjesa e dytë e eventit mbi Ditën e Gjeodetit

Kjo pjesë e dytë e kësaj dite ishte e organizuar në mënyrë të tillë që të gjitha qëllimet e Shoqatës të ishin sa më të prekshme nga të gjithë anëtarët e saj si dhe sa më transparente dhe të kuptueshme për të pranishmit.

Dyprezantimet e para kishin të bënin me transmentimin e funksionimit të profesionit të Gjeodetit në vende si Franca dhe Maqedonia. Konkretisht Z. Bledi Stefa i njohu të pranishmit mbi iniciativën e SHGJSH-së për hartimin e ligjit të Gjeodetit si dhe krijimin e Dhomës së Gjeodetëve të Liçensuar. Më pas prezantimi tjetër u bë nga Z. Nicolas Smith, përfaqësues i Dhomës Franceze të Gjeometrave Ekspert, njeherazi Z. Smith kishte edhe mbështetjen e Këshillit të Gjeometrave të Europës CLGE.



Prezantimin tjetër e solli Z. Jakup Fetai, Anëtar i Bordit Drejtues të Dhomës së Gjeodetëve të Maqedonisë i cili theksoi faktin që krijimi i strukturave të tilla për Shqipërinë do ishte vetëm në favor të Gjeodetit.

Edhe këtë rradhë kompanitë private sollën shumë inovacione të teknologjisë, oferta të ndryshme dhe opsione për klientët.

Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë gjen rastin t'ju shprehë një falenderim personave dhe kompanive mbështetëse si më poshtë:



Z. Azbi Arapi, Geotrim.
L.t.d, distributor i autorizuar i Trimble
Z. Ylber Shabani, Geotech.
Sh.p.k distributor i autorizuar i Sokkia
Z. Përparim Ndoi.
Land & Co distributor i autorizuar i Top Con
Z. Lorenc Zani. Lorenzo & Co
Mr. Ettore Catania, Stonex
Mr. Christos Vagias, JGC, partner of Spectra Precision
Mr. Zdenko Kutrovic Director, Carlson Software EMEA
Z. Besnik Hysaj, Geo Nord
Z. Romeo Nazarko
Z. Anri Saja
Z. Fatmir Ejupi
Z. Eriseld Hila
Z. Alban Suku
Kryesinë e SHGJSH-së
Albanian Young Surveyors



19 - 21 APRIL TIRANË, ALBANIA

**EUROPEAN GROUP OF SURVEYORS IN ALBANIA
EVENTI ME MADHËSHTORË I GJEODEZISË SHQIPËTARE
NË TË GJITHA KOHËRAT 25 PERSONALITETE TË GJEODEZISË
EUROPIANE NË SHQIPËRI**



Hyrje

Me ftesë të Kryetarit të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë Z. Bledi Stefa, prej datës 19 deri 21 prill 2012, Grupi European i Gjeodetëve vizitoi Shqipërinë. Përbërja e EGoS-it është mjaft e larmishme. Në të janë anëtar shtete nga më të zhvilluarat në mbarë Europën, por edhe jashtë saj. Aktiviteti i EGoS në Tiranë ishte përmbledhur në dy data kryesore, e para ishte data 20 prill 2012 në të cilën EGoS zhvilloi asamblenë e përgjithshme si dhe data 21 prill 2012 ku ishte planifikuar të zhvillohej seminar i hapur me tematika të ndryshme, me karakter teknik e profesional.

Vizita e Grupit European të Gjeodetëve në Shqipëri kishte edhe një karakteristikë shumë domethënëse pasi, siç e dime vendi ynë aspiron integrimin dhe bashkangjijtjen me Bashkimin European. Pjesmarrës në Asamblenë e Përgjithshme dhe seminarin e datës 21 prill, ishin përfaqësues të vendeve si, Malta, Britania, Belgjika, Greqia, Italia, Gjermania, Bullgaria, Serbia, Maqedonia, Kosova etj.

Mes EGoS-it, por edhe mes nesh ishte i ftuar edhe një mik shumë i mirë, madje një personalitet i Gjeodezisë Botërore, Presidenti i Këshillit European të Gjeodetëve Z. Jean-Yves Pirlot i cili vendosi të

udhëtonte nga Belgjika vetëm për të qënë pjesë e këtij eventi madhështor.

Në datën 19 prill 2012 persona të autorizuar nga SHGJSH bënë pritjen e delegatëve në ambjentet e Hotel Mondial, vendi ku do të zhvilloheshin konferencat. Evenimenti Gjeodezik European u organizua nga Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë me mbështetjen e një sërë institucionesh, individësh dhe organizatash vendase dhe të huaja. Mund të përmendim që mbështetja kryesore u dha nga Ministri për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Z. Genc Pollo. Gjithashtu, aktivitetin e mbështetën Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës, Struktura Young Surveyors (Gjeodetët e së Ardhmes), Kompanitë Private si Lorenc & Co, Gent Alba Sh.p.k, Geo Consulting, GeoTech Sh.p.k, Geotrim L.t.d, Land & Co, etj. Një falenderim special shkon për Kryesinë e SHGJSH-së si dhe për kolegët tanë Gjeodetë, Z. Romeo Nazarko, Anri Saja, Kostandin Qirjazi, Lorenc Zani, Edmond Lekaj, Azbi Arapi, Besnik Hysaj, Ylber Shabani dhe Përparim Ndoi. Gjithashtu, aktivitetet e ndryshme që SHGJSH ka organizuar ndër vite, kanë gjetur mbështetje edhe të shumë personave të cilët gëzojnë një mirënjohje të veçantë nga ana jonë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E EGOS, 20. 04. 2012

Zhvillimi i Asamblesë së Përgjithshme u bë nën kujdesin e Sekretarit të Përgjithshëm të EGoS-it Z. Malcolm Lelliott, me ndihmën e Z. Randolph Camilleri President i EGoS dhe Z. Bledi Stefa Kryetar i SHGJSH-së. Fjalën e hapjes së asamblesë e mori Presidenti i EGoS-it Z. Randolph Camilleri i cili, bëri hapjen e takimit si dhe informoi të pranishmit mbi etapat kryesore lidhur me aktivitetet e Grupit. Z. Camilleri nuk la pa përmendur edhe një numër të konsiderueshëm anëtarësh të cilët për arsye objektive nuk mund të ishin pjesë e kësaj asambleje. Gjithashtu, Presidenti renditi disa çështje si mbajtja e asamblesë në Qipro në datën 09. 12. 2012, mardhëniet me organizatat e tjera profesionale Europiane dhe Botërore, administrimi i EGoS dhe faqja zyrtare e internetit.

Më pas Z. Malcolm Lelliott Sekretar i Përgjithshëm i EGoS, u ndal në dy çështje të cilat lidheshin me trajnimin dhe edukimin, më pas i njohu të pranishmit mbi projektin e Kartës Profesionale EURGEO. Mbas Z. Lelliott fjalën e mori Z. Jean-Yves Pirlot President i Këshillit të Gjeodetëve të Europës (CLGE) i cili merrte pjesë në këtë eveniment historik, si i ftuar nderi. Z. Pirlot

informoi të gjithë delegatët prezent në sallë, mbi politikat dhe standartet e matjeve të sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme dhe pronave në përgjithësi.

Duke falenderuar SHGJSH-në si dhe EGoS-in për praninë e tyre në Shqipëri, Z. Alban Suku Drejtues i Strukturës Young Surveyors (Gjeodetët e së Ardhmes) paraqiti në mënyrë të përmbledhur progresin që kanë bërë AYS si dhe vuri theksin në rëndësinë që kanë Gjeodetët e Rinj kundrejt këtij trendi të zhvillimit. Z. Suku, në konsultime të vazhdueshme edhe me SHGJSH, hodhi iden e krijimit të Strukturës Gjeodetët Europian të së Ardhmes (Young Surveyors of Europe) e cila u mbështet edhe prej dy presidentëve të EGoS dhe CLGE.

Z. Nikolaos Zaxarias Zëvendës President i EGoS, mori fjalën duke prezantuar organizatat më të reja, candidate për të qënë pjesë e EGoS-it, si dhe paraqiti përpara delegatëve strategjinë e zhvillimit për të ardhmen. Gjithashtu, pak para fundit të Asamblesë së Përgjithshme u përcaktuan edhe Shtetet e tjera ku EGoS do të zhvillonte takimet e radhës. Tre prej tyre ishin Bullgaria, Maqedonia dhe Kosova. Fjalën e mbylljes e patën Z. Camilleri dhe Z. Lelliott dhe menjëherë pas tyre Z. Bledi Stefa Kryetar i SHGJSH-së, njëherazi Drejtues i Bordit të Evenimentit, informoi të pranishmit mbi hapat e programit në vazhdim.

21. 04. 2012

KONFERENCA E PËRBASHKËT EGOS – SHGJSH

Në konferencën e datë 21. 04. 2012 ishin të ftuar pothuajse 80 pjesmarrës të cilët patën rastin të ndiqnin fjalimet dhe prezantimet e ndryshme me tematika gjithpërfshirëse të Gjeodezisë dhe aplikimit të saj. Hapjen e konferencës e bëri Z. Bledi Stefa, Kryetar i SHGJSH-së i cili falenderoi Grupin Europian të Gjeodetëve për pjesmarrjen e tyre në Shqipëri si dhe Z. Genc Pollo, Ministër i MITIK për mbështetjen e dhënë këtij aktiviteti. Gjithashtu Kryetari i SHGJSH-së falenderoi mbështetësit e këtij aktiviteti si dhe të pranishmit në sallë. Menjëherë mbas fjalimit të Z. Stefa, fjalën e mori Presidenti i EGOS-it Z. Randolph Camilleri i cili falenderoi vendasit për pritjen e mrekullueshme që kishim organizuar si dhe i uroj Gjeodetëve suksese në punën dhe karrierën e tyre profesionale.

Më pas fjalën përshëndetëse e mori Z. Genc Pollo,

Ministër i MITIK i cili vuri theksin në Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë. Kjo reformë i përgjigjet gjithashtu detyrimeve të Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Europian. Institucioni që po merret me hartimin e politikave është Ministria e Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit. Z. Ministër theksoi gjithashtu rolin kryesor që ka shoqata në këtë reformë dhe e ftoi SHGJSH-në të ishte pjesë e konsultimeve të projekt-ligjit.

Mbas fjalëve përshëndetëse filluan prezantimet teknike nga referues të ndryshëm si; Kryetari i SHGJSH-së Z. Bledi Stefa, Kryeshefi i Agjensisë Kadastrale të Kosovës Z. Murat Meha, Drejtuesi i Albanian Young Surveyors Z. Alban Suku, President i CLGE Z. Jean-Yves Pirlot,

Z. Edmond Lekaj Anëtar i Kryesisë së SHGJSH-së si dhe Z. Malcolm Lelliott Sekretar i Përgjithshëm i EGOS-it.

VIZITA NË TUNELIN QË LIDH TIRANËN ME ELBASANIN

Me mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në veçanti të Z. Sokol Olldashi Ministër dhe Z. Ernest Noka Zëvendësministër, u bë e mundur realizimi i një vizite në rrugën më të re që lidh Kryeqytetin me një tjetër qytet të Shqipërisë, Elbasanin. Gjithashtu, një meritë kryesore përta i përketë kësaj vizite, ka edhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve si dhe Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i saj, Z. Skënder Çota. Kjo vizitë kishte një rëndësi shumë të veçantë jo vetëm nga ana profesionale por edhe përta i përket çështjeve me rëndësi kombëtare të Shqipërisë, siç mund të jetë aderimi drejt strukturave Europiane. Pritja në tynelin e Elbasanit u bë nga supervizorët e projektit. Fillimish të pranishmit u njohën me projektin, në zyrat që ata kishin ngritur pranë kantierit të punës. Mbas prezantimit lidhur me projektin si dhe organizimin e punës filluan të adresoheshin pyetje të ndryshme me karakter teknik

e profesional. Një tjetër risi e kësaj vizite ishte se të pranishmit arritën të shikonin punimet e terrenit si dhe të hynin brenda tynelit, deri në ballin e punimeve. Përpara hyrjes së grupit të persona në tynel, u realizua një shpërthim në tubin e krahut të majtë i cili, e bëri edhe më emocionuese vizitën si dhe përshkrimin në brëndësi të tynelit.

Mbasë kësaj vizite mbresëlënëse, në emër të organizatorëve u përcollën përshtypjet më të mira si dhe u pa qartë ambicja e vendin tonë në realizimin e projekteve madhështore të cilat jo vetëm që do përmirësojnë kushtet e infrastrukturës por edhe do të ndryshojnë imazhin tonë në arenën ndërkombëtare.

Udhëtimi drejt Apollonisë

Ditën e fundit të qëndrimit të EGOS-it në Shqipëri ishte planifikuar një vizitë 1 ditore në **Kryeqendrën Arkeologjike të Shqipërisë, Apolloni**. Grupi Europian i Gjeodetëve ishte i shoqëruar nga Kryetari dhe Anëtar të SHGJSH-së, gjithashtu edhe nga disa përfaqësues nga Struktura Gjeodetët e së Ardhmes.



Mbështetja e Z. Genc Pollo Dhe Bashkëpunimi Midis Ministrisë së Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit dhe Shoqatës Së Gjeodeteve Të Shqipërisë

Roli Dhe Rëndësia E Shoqatës Së Gjeodeteve Të Shqipërisë Në Reformën E Infrastruk- turës Kombëtare Të Të Dhënave Gjeohapësinore Në Republikën E Shqipërisë

Në përputhje me direktivën Inspire të Bashkimit European, Shqipëria po përpaket fuqishëm të bëjë hapa përpara mbi reformimin, organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Të Dhënave Gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë. Kjo reformë i përgjigjet gjithashtu detyrimeve të Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit European. Institucioni që po merret me hartimin e politikave është **MINISTRIA E INOVACIONIT, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT E TË KOMUNIKIMIT**. Fazat më të rëndësishme të cilat do kalojnë kjo nismë janë tashmë në një rrugë të mbarë. Shoqata e Gjeodeteve të Shqipërisë është një faktor shumë i rëndësishëm në këtë reformë, duke qënë se përfaqëson drejtë për së drejti grupin më të madh të interesit për hartimin dhe zbatimin e Infrastrukturës Kombëtare të Të Dhënave Gjeohapësinore. Në një mbledhje të posaçme me strukturat drejtuese të SHGJSH-së dhe anëtarëve të saj, janë shqyrtuar pikë për pikë të gjitha hapat që lidhen me këtë proces. Gjatë diskutimeve, është vënë theksi në ngritjen e strukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore e cila përbëhet nga Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor (ASIG) si dhe Bordi i Informacionit Gjeohapësinor.



Përfaqësues nga Shoqata e Gjeodeteve të Shqipërisë gjatë takimit në MITIK (nga e majta) Z. Romeo Nazarko, Z. Kostandin Qirjazi, Z. Genc Pollo Ministër, Z. Bledi Stefa dhe Z. Anri Saja





TRIMBLE M3: 1", 2", 3", 5"



TRIMBLE S3: 2", 5"

TRIMBLE S6: 1", 2", 3", 5"

TRIMBLE S8: 0.5" 1", 2", 3", 5"



TRIMBLE R4



TRIMBLE R6



TRIMBLE R8



TRIMBLE R10



GEOTRIM

SURVEYING ~ CONSTRUCTION ~ NIKON-TRIMBLE- GARMIN

Adresa: Rr. Lord Bajron, Vila Nr.1,
(Kryqëzimi kryesor i Laprakës)
Laprakë, Tiranë,

Tel: +35542257548, Mob: +355682055616
E-mail: geotrim.al@gmail.com; contact@geotrim.al
Web: www.geotrim.al; www.trimble.com

Prishtinë 14. 01. 2012

RAPORTI PËRMBLEDHËS

Me ftesë të Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës, një përfaqësi e SHGJSH-së merr pjesë në Kuvendin e IV-të zgjedhor, për zgjedhjen e strukturave drejtuese të SHGJK-së. Konferenca u mbajt në Kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë.

Në datën 14. 01. 2012, nisen nga Tirana një përfaqësi e përbërë prej, Kryetarit të SHGJSH-së Z. Bledi Stefa, Drejtuesit të Strukturës “Young Surveyors Gjeodetët e së Ardhmes” Z. Alban Suku si dhe dy prej përfaqësuesve të biznesit në SHGJSH, Z. Lorenc Zani Adriministratori i kompanisë Lorenzo & Co dhe Z. Ylber Shabani Administrator i kompanisë Geotech Sh.p.k përfaqësues zyrtarë i Sokkia. Konferenca u zhvillua në ambientet e Entit të Statistikës së Kosovës, shumë pranë qendrës së Prishtinës. Në të, morën pjesë rreth 60 persona nga qytete të ndryshme të Kosovës. Në rendin e ditës ishin një numër i caktuar pikash të cilat u diskutuan me gjithë të pranishmit në sallë. Nuk munguan debatet dhe diskutimet.

Në fjalën e tij, Z. Bledi Stefa Kryetar i SHGJSH-së, përshëndeti dhe falenderoi të pranishmit për ftesën si dhe mikpritjen e bërë. Ai vuri theksin në bashkëpunimin e ndërsjelltë midis SHGJK dhe SHGJSH si dy prej strukturave më të mëdha dhe më të rëndësishme Gjeodezike Shqipëtare, unifikimin e standarteve dhe zhvillimin e profesionit drejt strukturave Europiane dhe Botërore.

Nuk u la pa u përmendur data 22 Janar 2011 (DITA E GJEODETIT) si organizimi dhe mbledhja më madhështore e Gjeodetëve Shqipëtarë në të cilën, morën pjesë rreth 400 persona nga të gjitha trevat si; Ko-



sova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva dhe Shqipëria. Një tjetër pikë e fjalimit ishte puna për arritjet e bëra nga SHGJSH, zhvillimi i teknologjisë, rritja e numrit të gjinisë femërore që studiojnë në Gjeodezi etj. Mbas fjalës së Z. Bledi Stefa, për të pranishmit u caktuan 15 minuta pushim për të konsumuar një kafe apo çaj. Më tej, konferenca zhvilloi punimet me zgjedhjen e strukturave drejtuese të SHGJK-së. Me shumicë votash nga të pranishmit në sallë u zgjodhën:

Kryetar	Z. Murat Hoxha
Nën Kryetar	Z. Blerim Jashari
Sekretar	Z. Ymer Ratkoceri

Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë, e quan Kuvendin e IV-të zgjedhor të SHGJK-së si orjentimin e kësaj strukture drejt zhvillimit të profesionit, mbrojtjen e interesave të Gjeodetit si dhe vlerëson progresin që SHGJK arriti të bëjë në këtë Kuvend. Nga mbajtja e procesit zgjedhor u vu në dukje konsensus i gjërë midis palëve i cili solli si përfundim zgjedhjen e Kryetarit, Nën Kryetarit dhe Sekretarit të SHGJK-së. Për të zgjedhurit vendor, Kryetari i SHGJSH-së Z. Bledi Stefa, ndau dy çertifikata ku SHGJSH shprehte në mënyrë zyrtare mbështetjen e saj për SHGJK-në si dhe rritjen e bashkëpunimit midis dy strukturave. Tërheqja e çertifikatave u bë nga Kryetari Z. Murat Hoxha dhe nga Sekretari Z. Ymer Ratkoceri. Konferenca përfundoi rreth orës 14:00 ku të pranishmit u shpërndan duke përshëndetur njëri tjetrin. Në hollin e sallës ku u zhvillua mbledhja, u bënë fotografi të ndryshme të cilat zënë vënd në arkivat respektive të shoqatave.



Dt. 02. 09. 2011

MBLEDHJE E SHOQATËS SË GJEODETËVE TË SHQIPËRISË PËR “TARIFAT E PUNËVE TOPO-GJEODEZIKE”

Temat për diskutim

- Vendimin nr. 444, Datë. 05. 09. 1994 “Për Tarifat e Studimit, Projektimit, Drejtimit, dhe Kolaudit të Veprave të Ndërtimit”. Parashikimi i Punimeve Topo-Gjeodezike, për rruget, ujesjellesat, kanalizimet etj.
- Pjesmarrja e Topo-Gjeodetit në Grupin e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme
- Miratimi i Kodit të Matjeve për Sipërfaqet e Kateve të Ndërtesave



Në të u hodhën hipoteza dhe u bënë propozime të ndryshme mbi tarifën e punëve Gjeodezike dhe Topografike. Meqënëse kjo temë prekte një grup të gjërë interesi si dhe vetë problematika e çmimeve kerkonte një kohë më të gjatë për diskutim, u vendos ngritja e një grupi pune. Ky grup pune, do të marri në shqyrtim çdo material të nevojshëm si dhe çmimet e vendeve fqinje për ti krahasuar, dhe në datën 23. 09. 2011 do ti paraqes në mbledhjen e radhës së SHGJSH-së. Propozimet dhe Rekomandimet që do të dalin nga kjo mbledhje, do ti dërgohen zyrtarisht Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Në datën 02. 09. 2011, ditën e premte, ora 18:00, pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit u zhvillua mbledhja e Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë, për “Tarifat e Punëve Topo-Gjeodezike”. Qëllimi kryesor i mbledhjes ishte rishikimi i Vendimin nr. 444, Datë. 05. 09. 1994 “Për Tarifat e Studimit, Projektimit, Drejtimit, dhe Kolaudit të Veprave të Ndërtimit”.

Në këtë mbledhje morën pjesë, Kryetari i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë Z. Bledi Stefa i shoqëruar nga Nën Kryetari Z. Kostandin Qirjazi. Të pranishëm ishin Anëtar të Kryesisë së SHGJSH-së, përgjegjësit e disa prej qarqeve me kryesore, anëtar dhe simpatizant. Gjithashtu, në mbledhje morën pjesë edhe Anëtar Nderi të SHGJSH-së si dhe përfaqësues nga struktura Young Surveyors (Gjeodetët e së Ardhmes).

Një pikë tjetër e rendit të ditës ishte diskutimi mbi “Ditën e Gjeodetit”. Mbas festimit të 20 vjetorit të themelimit të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë, pjesmarrja e rreth 400 të pranishmëve faktoi që kurrë më parë nuk ishte bërë një mbledhje aq e madhe e Gjeodetëve jo vetëm në Shqipëri por as në Ballkan. Në të morën pjesë të gjitha trevat Shqipëtare si dhe personalitete të njohur të fushës dhe jashtë saj.



NJË JETË KUSHTUAR PROFESIONIT



Profesor Myfit Guxholli ka lindur në qytetin e Pogradecit në datën 07 Qershor 1930. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Në vitet 1945 – 1946 kryen dy vite mësimore në Liceun e Korçës. Në vitet 1946 – 1948 përfundon me rezultate të mira shkollën e mesme të përgjithshme ushtarake “Skënderbej” dhe në vitet 1948 – 1952 mbaron shkollën e lartë të topografisë ushtarake në Leningrad (Ish Bashkimi Sovjetik).

Gjatë viteve 1952 – 1961 kryen detyra të ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes si kryetopograf në degën e topografisë, shef i seksionit të topografisë dhe zëvendës shef i degës së topografisë.

Në vitet 1959 – 1964 kryen Universitetin e Tiranës dhe diplomohet inxhinier në specialitetin Gjeodezi. Profesor Myfiti, ka kryer detyra profesionale dhe akademike pranë Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve si pedagogë e shef cikli. Me krijimin e katedrave në vitin 1972 deri në daljen në pension, drejtoi Katedrën e Topografisë pranë Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve.

Aktiviteti jetësor e profesional i Prof. Guxhollit ka qenë shumë i lidhur

me Topografinë, Gjeodezinë dhe me shërbimin përkatës në vendin tonë. Në funksionet drejtuese që ka mbajtur në Ministrinë e Mbrojtjes jep një kontribut të shquar në organizimin e shërbimit gjeodezik. Vlen të theksohet përkushtimi dhe kontributi i dhënë në kuadrin akademik. Vite të tëra jete kushtuar arsimimit të brezave të rinj që studioan në degën e topografisë dhe gjeodezisë. Gjatë kohës që Prof. Myfiti ka ushtruar detyrën e pedagogut dhe shefit të katedrës pranë Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve ka pasur një aktivitet të pasur shkencor e pedagogjik, siç janë:

- Ka përgatitur cikle të plota të leksioneve në topografi, në gjeodezinë e lartë, në gjeodezinë inxhinierike si dhe leksionet e gjeografisë ushtarake për Akademinë e Mbrojtjes dhe atë “Skënderbej”.
- Në vitin 1986 boton tekstin mësimor “Gjeodezia” të përshtatur për studentët e specialitetit topografi në Akademinë “Skënderbej”.
- Në vitin 1960 me bashkëautorësi përgatit rregulloren e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për punimet e trekëndëzimit e të poligonometrisë për rlevimet e shkallëve 1:500, 1:1000 dhe 1:5000 si dhe rregulloren për normat e punimeve topo-gjeodezike.
- Pjesëmarrës në përpilimin dhe projektimin e projektit të rrjetit shtetëror të triangolacionit të

Republikës së Shqipërisë (arkiva IGJU 1954).

Profesor Myfit Guxholli ka një aktivitet të pasur në lidhje me përgatitjen e artikujve dhe kumtesave të ndryshme për problemet e zbatimit të Shërbimit Gjeodezik në Shqipëri, si më poshtë:

- Mars 1959 artikull në Revistën Njohuri Ushtarake, mbi furnizimin topografik të ushtrisë
- Maj 1977 kumtesë në Institutin Topografik të Ushtrisë me rastin e përvjetorit të Shërbimit Gjeodezik Shqiptar.
- Maj 1987 bashkëautor me Prof. Muharrem Dragovojën në kumtesën me rastin e 40 vjetorit të Shërbimit Gjeodezik Shqiptar.
- Pjesëmarrës në fotografimin ajror të territorit shqiptar (1955-56) së bashku me specialist të huaj, punë e cila vlejti për mbulimin e territorit shqiptar me harta topografike.
- Bashkëautor dhe zbatues i projektit të rlevimit me menzul të kufirit tokësor shqiptar 1200 km (arkiva në IGJU 1960)

Profesor Myfit Guxholli është Anëtar Nderi i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë për kontributin e lartë të dhënë në fushën e Gjeodezisë si dhe gëzon statusin e veçantë të trashëgimit të profesionit tek njerëzit e afërm të familjes.

Land&co *shpk*

Rruga Mine Peza pallati i ri 8-kt ngjitur
me porten e shkolles Hasan Vogli 6/1
Tirane, Albania
cel: +355 682035522
email: info@landcoal.com
Web: www.landcoal.com

**Perfaqesues i autorizuar per
Shqiperine**




Lorenzo & CO.

Mapping & GIS, Planning, Design, Engineering.

Mob. +355692051540: Web: www.lorenco-co.com: E-mail: info@lorenco-co.com

Kupa e Imaginatës - Imagine Cup

GENTI QIRJAZI FITON ÇMIMIN E PARË

Krenari për Shoqatën e Gjeodetëve të Shqipërisë dhe Gjeodezinë Shqipëtare që njëri prej kolegëve tanë, anëtar i SHGJSH-së, Z. Genti Qirjazi i cili ka përfunduar studimet pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi arrin të fitojë çmimin e parë.



Uorganizua për herë të parë në Shqipëri me bashkëpunimin e Ministrisë për Inovacionin dhe TIK, Kupa e Imaginatës-Imagine Cup, një konkurs ku kompania Microsoft inkurajon të rinjtë në të gjithë botën të përdorin imagjinatën, pasionin dhe krijimtarinë e tyre për të sjellë risi teknologjike që mund të sjellin ndryshimin në botë.

Në konkursin e zhvilluar në hotel Sheraton, në Tiranë, morën pjesë përveç profesorëve dhe studentëve konkurrues edhe Kryeministri i vendit z. Sali Berisha, Ministri për Inovacionin dhe TIK z. Genc Pollo, Ministri i Arsimit dhe Shkencës z. Myqerem Tafaj, kreu i USAID-it në Shqipëri z. Joseph Williams, si dhe përfaqës të biznesit TIK në vend. Fitues i çmimit të parë ishte projekti ALB2B (Albanian business to business) që kishte si synim ofrimin për bizneset dhe klientët (blerësit) një informacion transparent dhe në kohe reale duke nxitur rritjen e prodhimit vendas dhe tregtisë në Shqipëri. Ndërkohë i jepet mundësia fermerëve dhe artizanëve për të gjetur blerësit në mënyrë të drejtpërdrejte duke çuar në rritjen e konkurrencës dhe të ardhurave, që të cojnë në një impakt të drejtpërdrejtë në uljen e varfërisë. Aplikacioni ndodhet online në adresën <http://alb2b.uhurucloud.com>

Anëtarët e projektit ishin:

1. Genti Qirjazi (Universiteti Politeknik i Tiranës/Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit)
2. Milena Dyle (Universiteti i Tiranës/Fakulteti i Shkencave të Natyrës)
3. Ana Dhembli (Universiteti i Tiranës/Fakulteti i Shkencave të Natyrës)

Në vitin e saj të nëntë, me 1.4 milionë studentë pjesëmarrës në konkurs që nga viti 2003, Imagine Cup është bërë një ngjarje globale. Një vit më parë, në 2011-ën, Imagine Cup u zhvillua në New York, dhe në të u regjistruan më shumë se 325,000 studentë nga mbi 100 shtete të ndryshme

Këtë vit, për herë të parë, Imagine Cup zhvillohet edhe në Shqipëri (www.imaginecup.al), si një mundësi për profesionistët e rinj në vend, që të shfaqin krijimtarinë dhe gjenialitetin e tyre në praktikë, duke paraqitur zgjidhje për probleme reale, për të marrë pjesë në të ardhmen e teknologjisë, për të krijuar lidhjet me industrinë vendase të softuereve, për të vënë në përdorim aftësitë e marra dhe njohuritë, për të ofruar zgjidhje novatore dhe krijuese, si dhe për të marrë pjesë në finalen botërore të Imagine Cup, që këtë vit do të mbahet në Australi në korrik.

Tema e këtij viti është “Imagjinoni një botë ku teknologjia ndihmon në zgjidhjen e problemeve më të vështira”, duke ofruar zgjidhje novatore softuerike që janë në përputhje me Sfidat e Mijëvjeçarit, të identifikuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara – duke filluar nga ulja e varfërisë dhe ndalimi i përhapjes së HIV/AIDS-it deri në ofrimin e arsimit fillor universal.

Në fazën fillestare u kontaktuan dhe u punua me 22 universitete dhe fakultete publike dhe private në vend, si dhe u regjistruan në fazën përfundimtare 20 ekipe studentore me projektet e tyre nga 10 universitete dhe fakultete publike dhe private.

"Shqipëria do të jetë më e bukur duke punuar bashkë"

Edison Sinanaj

Administrator

Edison themeloi "Geo-Sky" në shkurt 2005 dhe ka qënë administrator i kompanisë gjatë gjithë kësaj kohe. Ai punon për të siguruar manaxhimin dhe koordinimin e punës së kompanisë dhe supervizon stafin. Edison është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, në fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me titullin e diplomës Inxhinier Gjeodet. Ai gjithashtu është supervizor i punës së stafit dhe udhëheq pothuaj të gjitha projektet. Edison është Anëtar i Këshillit Drejtues të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë.

Edison ka një eksperiencë të gjatë në manaxhim sepse përveç se administrator i "Geo-Sky" ai ka qënë që nga viti 2004 deri në vitin 2011 administrator dhe aksioner i kompanisë së ndërtimit "Hapësira X". Ndërsa në Maj të 2012 ai bëhet edhe administrator dhe aksioner i kompanisë së ndërtimit "European Vision Construction".

Portofoli i Kompanisë

Që nga viti 2005 kompania ka realizuar shumë projekte dhe ka një portofol shumë të gjërë. Specialistët kanë realizuar shumë punë topografike dhe gjeodezike si:

- 1- Rrugë
- 2- Studimin e Fizibilitetit
- 3- Punë Kadastrale
- 4- Studimeve urbanistike
- 5- Konstruksione metalike
- 6- Hidrocentrale
- 7- Etj.

Stafi

Qemal Sinanaj
Artan Hoxha
Sokol Cullhaj
Arbër Istrefi
Ardit Lisi

"GEO-SKY" shpk
Studio Gjeodezike



Adresa: "Kongresi i Lushnjes" St., building 18/3
Tel/Fax: +35542225072
Cel: +355692078883
Email: geosky_studio@yahoo.com
Website: <http://geo-sky.wix.com/geo-sky>
Media Sociale
Facebook: <https://www.facebook.com/geoskystudio>
LinkedIn: <http://www.linkedin.com/pub/geo-sky/51/418/78a>



The Albanian Association of Geodesy

with the kind cooperation of

The Italian Consiglio Nazionale Geometri

organized the Seminar

Geo-referencing of Cadastral maps

Teacher Surveyor Gianni Rossi

The event was sponsored by



Who presented the software



Geo-referencing and Calibration of Maps

Get real geometric information from your maps

www.corrmmap.com sales@corrmmap.com



AGJENSIA ALBINFO

Kliko:

www.albinfo.al
www.albania-map.com

GJEJ:

HOTELE BARE RESTORANTE PLAZHE
EMER RRUGE INSTITUCIONE KOMPANI
PARK NATYROR KALA PARK ARKEOLOGJIK
PRONA - APARTAMENTE - DYQANE - TOKA

Real Estate
7438
Percakto kerkimin Resultatet(0)
Informacion Kërko
Emër
Rreth
Kategori
KONTAKTI:
r.nazarko@gc-al.com
Cel: 0672892912
0682226362
0692315246
Agjensia Albinfo
Portali online realizuar nga Geo Consulting Albania

- Qellimi i ketij projekti eshte qe keto faqe inteneti te sherbejne si nje portal infomacioni shumeqellimesh.
- Ky projekt ploteson nevojat per informacion ne fushat e Turizmit, Biznesit dhe Real Estate

IMPROVING DAM SAFETY BY GEODETIC MONITORING MEASUREMENTS



0-Reading at Qyrmaq dam

As a mountainous country Albania holds a big potential of hydro power and is using it for a long time yet. Spread across the country there are several hydropower plants with big and small dams. All these dams are maintained and under the responsibility of KESH (Korporata Elektorenergjitike Shqiptar). Therefore KESH is responsible to ensure the safety of these dams. Every artificial water reservoir bears a certain hazard to the local population, but it also bears a value that needs to be protected and maintained. Therefore KESH has initiated a project to improve dam safety and ensure the operation of these hydropower dams.

Contractor

In spring 2012 BSF Swissphoto, a Swiss based geo-engineering company, has been awarded to carry out the work within the geodetic dam monitoring project. The whole project is financed by SECO, the Swiss State Secretariat for Economic Affairs

Project

The project deals with the implementation of a geo-

detic monitoring system at six hydropower dams and one land slide area. The intention of this project is not only to plan, materialise, measure and report a geodetic dam monitoring system but also to procure the relevant equipment, hand it over to the client and train the client's staff so that in the future, the measurements on these dams can be continued by KESH's own staff.

Dams

The six dams and one land slide area are spread over five sites in the north of Albania namely Fierza, Koman, Vau Dejes, Ulza and Shkopet. The dams are between 50 and 160m high and are either rock fill or concrete gravity dams. The dams are between 25 and 55 years old and have not been geodetically monitored in the near past.

Work

BSF Swissphoto started in spring 2012 with site visits to plan a geodetic network for each dam site. In the beginning the site visits were accompanied by a geologist, who indicated stable rock locations where the pillars, which represent the reference frame for the geodetic



Pillar under construction

measurements, were built afterwards.

In total 45 massive reinforced concrete pillars and additional reference bolts have been built and installed to ensure a stable and redundant reference frame. Most of the civil work was carried out during the hot summer months. Some of the areas were inaccessible by motor vehicles and so all the material for the pillars had to be transported by mules or man or sometimes by therefore installed cable-cars.

After finishing the civil work phase in September, a team consisting of surveying specialists from BSF Swissphoto and KESH carried out the geodetic measurements for the 0-Reading. The measurements were taken with a Leica Totalstation TM 30 and a Leica DNA10 Leveling. The TPS measurements were taken from the Pillars with several sets of angles. The conditions on site were good and in average an accuracy of 0.7" for an averaged angle and 1mm + 1ppm for the distances have been achieved. All deformation points within the dams and rock fall



Levelling Training

or land slide areas were measured at least two times to increase the accuracy and to gain reliable results.

Training

The local staff has been trained on the handling of the new equipment to carry out state of the art geodetic dam monitoring measurements. Furthermore a geodetic evaluation software has been implemented and trained within the principals staff. The first part of this project has successfully been completed in November 2012.

Outlook

In spring 2013 the first sequence readings will be taken, again by a team consisting of specialists from BSF Swissphoto and KESH. Also the training of the client's staff will be intensified to ensure a sustainable success of this project.

Text and Fotos: Michael Furrer BSF Swissphoto AG
www.bsf-swissphoto.com



0-Reading at Fierza HPP

Editorial nga Julian Ismaili

TAKIMI MË I MADH I GJEODETËVE EVROPIANË ISHTE KËTË HERË NË HANOVËR TË GJERMANISË NGA 10 DERI ME 13 TETOR 2012.



Në këtë qytet, nga më i madhi në Gjermani përsa i përket organizimeve të panairove dhe ekspozitave, u mbajt ai i Gjeodezisë i njohur më mirë me emrin IN-

TERGEO gjithashtu edhe Konferenca III-të e Gjeodezëve evropianë e ndjekur nga Asambleja e Përgjithshme e vjeshtës e CLGE-së (Komiteti i Lidhjes së Gjeodezëve Evropianë) në të cilën Shoqata e Gjeodezëve Shqiptarë është antare që nga shtatori i vitit 2011 (shiko N°1 të revistës Gjeodeti).

E gjitha filloi në 10 tetor me takimin e studentëve evropianë të gjeodezisë : 280 studentë nga gjithë Evropa bënë takime me përfaqësues të profesionit, merrnin pjesë në prezantime të ndryshme të firmave të materialeve dhe shërbimeve gjeodezike, hartografike dhe fotogrametrike, GIS, GPS etj. Si dhe njiheshin me aktivitetet e ndryshme të gjeodetit dhe aparaturave më të fundit. Ishin jo më pak se 520 stande dhe gjatë 3 ditëve janë numëruar 16 000 vizitorë, ndër të cilët kishte vizitorë nga Shqipëria e Kosova.

Nga dëshmitë spontane të gjeodezëve të rinj, ata e kanë vlerësuar shumë këtë rast të veçantë të pjesëmarrjes së tyre në takimet evropiane. Një i diplomuar i ri belg, më thoshte se ishte i befasuar nga shumëllojshmëria dhe madhështia e aktiviteteve që ushtronin firmat e mëdha gjeodezike. Ai thoshte se që nga ora e parë e vizitës ishte i dekurajuar kur shihte se kjo teknologji moderne që ekziston, përdoret relativisht pak në vendin e tij. Është gjithashtu e vërtetë që evolucioni teknologjik është aq i shpejtë sa që koha midis fillimit të zhvillimit të teknologjisë dhe vënies në treg të tyre nuk mund të ndiqet.

Në ditën e dytë, 11 tetor, u mbajt Konferenca III-të e Geodezëve evropianë.

Sipas organizatorëve, konferencat e CLGE tërhoqën vëmendjen e pjesëmarrësve. Morën pjesë jo më pak se 1 400 veta në 40 prezantime ndërdisiplinore të dhëna paralelisht në tre tema kryesore : krahasimi i mbrojtjes së të drejtave të pronës në Evropë, përafrimi i kadastrës gjermane në moshën e dixhitalizimit dhe kodi i matjeve të sipërfaqeve, i cili momentalisht nën impulsin e CLGE-së do të njihet nga institucionet evropiane nën titullin euREAL-label (për më tepër informacion shih: <http://www.eureal.eu/> ose ne websitin e CLGE : <http://www.clge.eu/>).

Më në fund, e premtdja 12 dhe e shtuna 13 tetor, ju përkushtuan Asamblesë gjysëm-vjetore të vjeshtës të CLGE. Shumë tema ishin të shënuara në axhendë. Ishin të përfaqësuar 31 vende me rreth 60 delegatë ndër të cilët edhe Shqipëria me dy delegatët e saj Kryetarin Ble-di Stefa dhe unë.

Gjatë gjysmës së parë të mbledhjes statutore, mbas aprovimit të proces-verbalit të asamblesë së marsit në Edinburg, u zgjodhën antarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv. Jean-Yves Pirlot (Belgjikë) u rizgjodh me unanimitet dhe duartrokite si Kryetar i CLGE. U rizgjodhën në të njëjtën kohë : Michelle Camilleri (Malte) si Sekretare e Përgjithshme dhe Dieter Seitz (Gjermani) si Arketar. Gjithashtu Leiv Bjarte Mjøs (Norvegji) u rizgjodh si Zv/Kryetar. Si Zv/Kryetar u zgjodhën Danko Markovinov (Kroaci) dhe Pedro Ortiz (Spanjë).

Gjendja financiare e CLGE është e shëndetshme dhe solide ; buxheti për 2013 dhe kontributet e shteteve antare u miratuan unanimisht.

U vendos që Asebletë e Përgjithshme të ardhshme do të bëhen respektivisht në Budapest (Hungari) më 22-23 mars 2013 dhe në Chisinau (Moldavi) më 4-5 tetor 2013. Me 22 mars festohet gjithashtu Dita e Gjeodezëve

dhe Gjeomaticienëve Evropianë. Ndër të tjerash, u vendos gjithashtu që asambleja e pranverës në 2016 të bëhet në Shqipëri.

Në mengjesin e 12 tetorit u bënë edhe prezantimet nacionale të cilat u hapën me prezantimin e aktiviteteve të SHGJSH nga Kryetari ynë Z. Bledi Stefa. Ky prezantim u mirëprit dhe u duartrokut nga delegatët, disa nga të cilët u ngritën në këmbë dhe shtrënguan duart me Bledin duke i uruar shoqatës sonë vazhdim të mbarë.

Personalisht, unë vlersova organizimin e workshop-eve, ku secili, të ndarë në katër grupe pune, ka mundësi të diskutojë mbi tema që kanë të bëjnë me zhvillimin e profesionit. Kështu erdhi një ide origjinale nga Zvicra : Blueparking gjeodetët që punojnë në terren, në mënyrë krejtësisht vullnetare, vendosin në një databazë vëndet e parkimit publik që janë të rezervuara për personat me lëvizshmëri të kufizuar. Asambleja e Përgjithshme ishte entuziaste mbi këtë temë dhe vendosi për të studjuar projektin.

Midis të tjerash, u dhanë sqarime specifike nga vendi mikpritës rreth së ardhmes së “Kadastrës gjermane” dhe zgjidhjet që rezultojnë në lidhje me praktikën kadastrale, si dhe mbi aspektet e veçanta dhe tendencat aktuale në metodat e matjeve topografike.

Për të mbyllur këtë editorial, po përsëris akset kryesore strategjike të CLGE. Po ju kujtojmë se ky Komitet përfaqëson shumicën dërmuese të gjeodetëve të Evropës së

madhe, nga Rrethi Arktik deri në Mesdhe, nga Uralet në Oqeanin Atlantik. CLGE-ja është bashkëbiseduesi i privilegjuar me institucionet evropiane. Objektivat e saj kryesore janë : të jetë e përfshirë aktivisht në organet vendim-marrëse dhe të forcojë imazhin e gjeodetit evropian. Në këtë kontekst u iniciua në Hanovër sindromi i bukëpjeksis : të gjithë e dinë se çfarë bën bukëpjeksi, por shumë pak bukëpjekës dhe të tjerë e njohin profesionin tonë. Rezultati : qytetarët nuk i njohin aktivitetet tona ose i ngatërrojnë me ato të profesioneve të tjera, nga ku, kredibiliteti ynë bie dhe ne nuk përfitojmë nga situatat.

Një theks i veçantë duhet ti jepet motivimit të gjeodetëve të rinj për të marrë pjesë në shoqata të ndryshme në vendin e tyre por edhe në nivelin ndërkombëtar. Presidenti theksoi se ai është vigilent ndaj shpresave të antarëve të CLGE. Kështu, CLGE përpaket të qëndrojnë sa më pranë antarëve të saj në një botë që reagon dhe komunikon shumë më shpejt me anën e medias.

Jean-Yves Pirlot theksoi përsëri : CLGE duhet të jetë proaktive, më konkretisht tek autoritetet kompetente për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e gjeodetëve, por edhe në lidhje me partnerët tanë. CLGE mbështetet pothuajse tërësisht nga vullnetarë, ai duhet të dallohet me profesionalizmin e tij.

Julian Ismaili

NDERIME TË FIGURAVE TË SHQUARA TË PROFESIONIT

ANËTAR NDERI I SHOQATËS SË GJEODETËVE TË SHQIPËRISË HONORARY MEMBER OF ALBANIAN ASSOCIATION OF GEODESY

SHKOLLA E MESME TEKNIKE
“28 NËNTORI” KOSOVË

MR. RANDOLPH CAMILLERI

MR. JEAN-YVES PIRLOT

PROF. MYFIT GUXHOLLI

MR. JONATHAN ALBERT PRESIDENT

UNION DES GÉOMÈTRES DE MONS

Z. RIFAT HASA

I nderuar Z. Kryetar - Bledi Stefa

Isha i nderuar që unë së bashku me një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës të marr pjesë në shënimin e ditës së Gjeodetit e përcaktuar nga Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë. Padyshim se ishte kënaqësi e veçantë pjesëmarrja dhe gërshtetimi i gjeneratave të gjeodetëve, të cilët në faza të ndryshme kohore kontribuan në ndërtimin e kapaciteteve nga fusha e gjeodezisë. Ishin ata të cilët u sfiduan para shumë vështirësive për të vënë themelet e gjeodezisë në Shqipëri, ata që tani janë bartës të komunikimit dhe bashkëpunimit profesional dhe intelektual, ndërsa tani janë simbol i një bashkimi në ecjen tonë drejt integriteteve dhe krijimit të standardeve unike evropiane. Ishte mbresëlënëse, pjesëmarrja e gjeodetëve të rinj të cilët janë perspektiva jonë por edhe bartës të aktiviteteve të ardhshme në nivelin kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Kuptimplote ishte edhe prezenca e femrës gjeodete e cila çdo ditë e më tepër është protagoniste e vlerave pozitive si dhe bartëse e përgjegjësive në krijimin e gjeoinformacioneve, ndërsa konfirmuese e aplikimit të teknologjive të reja, ishte pjesëmarrja e kompanive dhe gjeodetëve të licencuar para të cilëve është një vëllim pune mjaft i madh në Shqipëri dhe jashtë saj.



Ju përgëzoj gjithashtu për punën dhe angazhimin tuaj në botimin e revistës GJEODETI e cila gjithsesi po behet kërkesë shpirtërore e jona. Revistë me një kualitet të mirë dhe përmbajtjesorë, është një sinonim suksesi i, shoqatës në përgjithësi por i kryesisë dhe kryetarit të saj në veçanti.

Unë në emër të Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës, zotohem se do të bëj përpjekje të mëdha bashkëpunimi, në ngritjen e kapaciteteve tona duke shkëmbyer përvojat tona, nga praktikat e gjeodezisë, legjislacioni, arsimi pse jo edhe bashkëpunimi me projekte të caktuara.

Kryetari i Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës
Murat Hoxha

Kronika e një Suksesi

Është kënaqësi ta kesh në kujtesë, fillimin e një procesi të rëndësishëm fillet e të cilit ngërthenin në vete jo vetëm elementët e një projekti të madh profesional, por edhe politikë, ishte një zgjim i përgjithshëm, ishte kthesë kah një rrugë suksesi dhe bazament i një shteti të ardhshëm.

Ishte mbase e imponuar që më 1968 të ndodhë demonstrata në Kosovë, të koordinuara edhe me faktorin politik shqiptarë në Kosovë dhe Shqipëri, ku ta dimë mbase edhe faktori i jashtëm kishte gisht në këto ngjarje, por një gjë është e vërtetë se pas atyre demonstratave e dinte qeni të zotit, Politikanët filluan aktivitetet në nxjerrjen e Amendamenteve Kushtetuese për Kosovën, ndërsa ekspertët e paktë në numër por të ditur shumë, bënë politikën e tyre me profesion, e

ndihmuan revolucionin politik por njëkohësisht hapen shtigjet për të krijuar kuadro profesionale të ardhshëm. Në vjeshtën e vitit 1969, u bënë përpjekje që të sigurohet numër i mjaftueshëm i nxënësve shembullorë nga trojet Shqiptare në ish Jugosllavi, për të filluar mësimin gjenerata e parë e gjeodezisë në kuadër të Shkollës së mesme teknike në Gjakovë. Me 10 Nëntor 1969 u mbajt ora e parë e mësimi, kjo ishte dita e projektuar që të shpallet dita e Gjeodetit në Kosovë.

Amendamentet Kushtetuese për Kosovën u miratuan më 1970, Kosova projektohej si element i Federatës Jugosllave, ndërsa Kushtetuta e parë u miratua në vitin 1974. Kjo ishte edhe një bazament i avancimit politik të Kosovës

Krahas këtij progresi politik të Kosovës, Shkolla e mesme e Gjeodezisë më 1973 promovoi gjeneratën e parë të diplomuarve. Bartës së aktiviteteve mësimore për këtë gjeneratë dhe gjeneratat të tjera ishin të përfshirë gati të gjithë inxhinierët e gjeodezisë së asaj kohe, respektivisht Prof. Kamer Nela, Prof Xhavit Vula, Prof Sadik Polloshka, Prof Xhemail Lezliu, Prof Gazmend Tuli etj .

Më 1969 ishte viti kur filloi funksionimi i Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës, që ishte degë e Lidhjes së inxhinierëve të Gjeodezisë në Ish Jugosllavi. Shkolla e mesme dhe Shoqata ishin promovuese të profesionit të Gjeodetit, kështu që shumë të rinj kryesisht nga kjo shkollë por edhe nga drejtimet të tjera vijuan studimet në Zagreb, Sarajeve, Beograd etj.

Rezultatet e para të këtij projekti u vunë në dukje që në vitin 1978 kur dolën inxhinierët e parë nga gjenerata e shkollës së mesme të Gjeodezisë. Ata menjëherë vazhduan projektin e nisur nga profesorët e vetë, duke ecë në një rrugëtim të vështirë deri në vitet e 90' ta, kur ndodhi largimi masiv i punëtorëve nga puna.

Periodha 1990-1999 ishte periudha më e vështirë për profilin e gjeodezisë nga se Institucionet e dhunshme në Kosovë kishin privuar të drejtën e punësimit, dhe shumë të drejta të tjera të shqiptarëve në përgjithësi. Megjithatë një numër i vogël i ndikuar në rrethanat e atëhershme dolën jashtë Kosovës për të studiuar Gjeodezinë, numër i konsiderueshëm ishin në Zagreb, Sarajeve, Lubjanë

por edhe ca sosh jashtë zonës së Ballkanit.

Në luftën e fundit në Kosovë u përfshinë një numër i konsiderueshëm i kolegeve tanë disa prej të cilëve ranë dëshmorë për lirinë e Kosovës si Besim Ndrecaj i cili ishte pjesë aktive e këtij rrugëtimi përfshi edhe atë luftarak.

Edhe pas Lirisë së Kosovës projekti i filluar nuk kishte mbërritur pikën e parashikuar të ovulimit. Shqiptarët e Kosovës ishin totalisht të izoluar, regjimi i Vizave që edhe sot na bën të ndihemi të mbyllur si shtet na detyroi që të vazhdojmë projektin e nisur që me 1968. Më të motivuarit për iniciativën e hapjes së Institucionit të edukimit universitarë publik në Kosovë, ishin anëtarët e Kryesisë së Shoqatës në krye me Kryetarin Selim Cacaj, Maxhun Hysenaj, Abdurrahman Kuleta etj. Aktiviteti i Shoqatës, Përgjegjësit e Ministrisë, Universiteti i Prishtinës ndikuan që më 2003/4 të fillohet me studimet në degën e Gjeodezisë në Kuadër të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Viti i kaluar ishte jubilarë për nga numri i studentëve të diplomuar në nivelin Bchl, u arrit kuota 100, tamam i përputheshëm me 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe Ditës së Flamurit Kombëtar Shqiptarë.

Murat Hoxha

Kryetar i Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës

STUDIO TOPOGRAFIKE BYLIS

Studioja jonë funksion që nga viti 2007 duke iu shërbyer mbi 15 000 klientëve në Tiranë dhe në gjithë territorin shqiptar. Studioja udhëhiqet nga ekspert Gjeodet Gjergj Begaj i cili ka kryer studimet në fushën e topografisë dhe hartografisë. Që prej katër vitesh studioja jonë bashkëpunon me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Tiranë dhe gëzon respektin e mijërave klientëve.

SHËRBIMET QË OFROJMË:

- Rilevime topografike pa limit
- Studime topografike inxhinierike
- Studime teknike për pronat
- Plane Rilevimi për Zrpp
- Planimetri
- Ekspertiza Teknike Topografike për AKKP-në
- Projekte civile industrial



Kontakti

Rr."Jordan Misja", përballë Hipotekës
1001 Tirana, Albania

Tel.: +355 2 2403101

Fax: +355 2 2403101

Cel.: +355 69 40 93431

E-mail: info@bylis-imobiliare.com

Web: www.bylis-imobiliare.com

Nisma

MBI HARTIMIN E “LIGJIT TË GJEODETIT” DHE PARASHIKIMI I KRIJIMIT TË “DHOMËS PROFESIONALE”

Nga Bledi Stefa

Funksionimi i profesionit të Gjeodetit, në shumicën e vendeve më të zhvilluara europiane dhe botërore është i rregulluar me ligj dhe me struktura profesionale që kryesisht quhen “Dhoma Profesionale”. Këto dy element shumë të rëndësishëm për profesionin tonë bëjnë të mundur një funksionim sa më të mirë të punëve të ndryshme gjeodezike. Qëllimi kryesor i ligjit ka të bëjë me të drejtat e aplikuara që i jepen Gjeodetit ndërsa ngritja e dhomës profesionale bën të mundur ruajtjen e këtyre të drejtave si dhe zhvillimin e tyre kundrejt çdo inovacioni të mundshëm.

Ligji rregullon performancën e aktivitetit profesional të Gjeodetit në aspektin shtetëror, studimor, kadastral, linjat e shërbimeve, detyrat profesionale gjeodezike, zhvillimet rajonale, ndërtimet, detyrat në zonat e mbrojtura, real estate etj. Detyrat profesionale gjeodezike kryhen si shërbime nga persona juridik e fizikë të cilët janë të regjistruar edhe në shoqata të cilat mbrojnë interesat profesionale.

Dhoma e Gjeodetëve ose struktura të tilla të ngjashme, referuar vendeve si Italia, Greqia, Maqedonia, Austria, Belgjika, Gjermania, Australia etj, ndërrmarin nisma ligjore në mbrojtje të interesave të përbashkëta profesionale. Hartojnë standarte në fusha të ndryshme të cilat janë të zbatueshme për cilindo profesionist që dëshiron të ushtrojë profesionin e tij.

Krijimi i Dhomës Profesionale është i parashikuar në ligj, pra në deontologjinë e Gjeodetit, prej këtej, kësaj strukture profesionale i lind e drejta të liçensojë cilindo Inxhinier Gjeodet që dëshironë ta aplikojë profesionin në jetën e përditëshme. Gjithashtu, “Dhoma e Gjeodetit” ka atributin e heqjes së të drejtës së ushtrimit të profesionit, në rastet kur Gjeodeti aplikon shkelje të rregullave dhe ligjeve, standarteve profesionale si dhe kodit të etikës. Por jo vetëm kaq.

Dhoma e Gjeodetëve hynë në marrdhënie bashkëpunimi edhe me struktura të ngjashme në mbarë botën. Shkëmben eksperiencën dhe është e obliguar të sjell çdo zhvillim të ri që ndodhë në vende të ndryshme.

Nëpërmjet konferencave apo seminareve me tema të veçanta, Dhoma e Gjeodetëve bën të mundur azhornimin e të gjithë anëtarëve të dhomës me ligjet, rregulloret apo risitë më të reja. Në këtë rast të gjithë anëtarët e dhomës janë të interesuar pasi në mënyrë automatike janë të informuar me çdo ndryshim që ndodhë me profesionin.

Dhoma e Gjeodetëve, në respektim të ligjit mbi performancën e zhvillimit të aktiviteteve gjeodezike, rregullon mardhëniet për cilindo shtetas të huaj që dëshiron të ushtrojë profesionin e Gjeodetit në Republikën e Shqipërisë. Miratimi i ligjit mbi performancën e zhvillimit të aktiviteteve gjeodezike, i jep dhomës atributin e krijimit të database-ve të ndryshme, të anëtarëve të regjistruar si dhe të punëve me interes të përbashkët.

Theksojmë që dhoma është një organizëm i pavarur, e regjistruar në gjykatë e cila ka vulën, pullat dhe selinë e saj. Dhoma ka për detyrë të paraqesë përpara shtetit dhe organizmave shtetëror, punën e saj dhe detyrat e ngarkuara nga ligji. Aktiviteti i dhomës është publik.

Në statutin e dhomës parashikohet i gjithë funksionimi i saj që nga emri, adresa, simboli, strukturat drejtuese dhe mbikqyrëse, zhvillimi i asambleve, raporti me shtetasit e huaj, specializimet permanente, rregullat e regjistrimit dhe anëtarësimit në dhomë. Gjithashtu statuti parashikon, ruajtjen e regjistrimit dhe zhvillimin e tij, menaxhimin e të dhënave të ndryshme, rregullat e votimit për strukturat drejtuese, e deri tek administrimi i burimeve financiare si dhe partnerшипet e ndryshme.

Në përfundim ne si profesionist, ju bëjmë thirrje të gjitha strukturave të larta shtetërore për marrjen e masave për fillimin e procedurave të hartimit të ligjit “Mbi performancën e zhvillimit të aktiviteteve gjeodezike” si dhe parashikimin e krijimit të “Dhomës Profesionale”.





Kontakt:

Adresa: Rruga "Jordan Misja"
përballe hipotekës, Tiranë
Email: brunalaze@yahoo.it
Tel: +355 68 60 12 056, +355 66 60 12 056

Punime Topo – Gjeodezike për:
Rrugë urbane dhe rurale
Kanalizime të ujërave të zeza dhe të bardha
Antena telefonike
Linja të tensionit të lartë
Ndërtesa një dhe shumë katëshe
Tunele
Punime portuale
Vlerësim i pasurive të paluajtshme
Piketime objektsh Inxhinierike
Konflikte Pronësie
Objekte të cilat janë në proces privatizimi etj

Bashkëpunime:
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave
Leje ndërtimi në Bashki dhe Komuna
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë
Gjykatat e Rretheve të ndryshme
Studio Përmbarimore Private dhe Shtetërore
Bankat
Etj

Disa fjalë për revistën "Gjeodeti"



gjitha këto Gjeodeti ka rolin e rëndësishëm në shoqëri. Ditën derisa e përgatis këtë shkresë për Revistën "Gjeodeti" është mot i ftohtë dhe me vërshime të mëdha në disa rajone të Kosovës. Pikërisht kjo më bënë përshtypje se si Gjeodeti mund ta ndihmoi me gjeoinformacion në harta të azhornuara, dhe me ndërlidhje me vendet e Evropës Perëndimore, nëpërmjet Asociacionit Euro-Geographic (EG). Në EG zhvillohet sistemi «Harta për rastet emergjente» e cila i temë u trajtua në Konferencën «EuroGeographics Emergency Mapping Knowledge Exchange Network» në Kopenhagën, me 28 Shkurt dhe 01 Mars 2013, në të cilën isha pjesëmarrës i aktiviteteve. Prandaj shtroi pyetjen si dhe sa Ne Gjeodetët Shqiptar mund ta ndihmojmë vendin në raste emergjente para,

gjatë dhe pas krizës së krijuar? Cilat produkte dhe gjeoinformacione të gjeoreferencuara e të azhornuara mund t'i fusim në shfrytëzim të menjëhershëm? Me një organizim më të koordinuar dhe me këmbëngulësi më të madhe profesionale mund të ofrojmë qasje në më shumë harta e koordinata nga profesioni ynë si pjesë përbërëse e INGJH (engl.NSDI). Efektshmëria e shërbimeve në administrimin dhe menaxhimin e tokës është e varur nga komponentët: plotësimi i standardeve, mbledhja dhe harmonizimi i gjeoinformacioneve si dhe shfrytëzimi i teknologjisë moderne për shpërndarjen e të dhënave nëpërmjet Web-aplikacioneve. Në këtë drejtim rol të mire është duke luajtur edhe Revista "Gjeodeti", e cila nëpërmjet formës së zgjedhur publicitare ofron informacione për të gjitha kategoritë nga pak, dhe duke hapur mundësinë për vazhdim të hulumtimit. Informimi dhe publiciteti në shoqërinë e tanishme të digjitalizuar janë domosdoshmëri, ndaj uroj që në shoqërinë Shqiptare, Revista "Gjeodeti" të ofroi sa më shumë informacione nga lëmi ynë duke gjetur edhe mbështetjen e duhur nga shoqëria.

Suksese.
Me respekt,
Prof. Dr. Murat Meha

Përparësitë që duhet të ketë Shoqata e Gjeodeteve

Si në çdo fushë tjetër në shqipëri ku hapësira e specialistëve cungohet dhe politika gllabëron gjithçka, hapsirat për zhvillimin dhe përparimin e shkencës së Gjeodezisë janë të limituara.

Mundësitë e teknologjisë sot janë të pa fundme, ajo që ne na intereson më shumë është të nxjerrim në pah të mirat e tyre si dhe si mund ti shfrytëzojnë në të mirë të fushës tonë.

Një panoramë mëse të qartë për mosfunksionimin e shoqatës na jep ALBPOS e cila ishte një ndër idetë më të shkëlqyera e që do ti vinte në ndihmë si shoqërisë ashtu dhe zhvillimit të vendit por që rezultoi një dështim.

Ne mbështesim shoqatën e Gjeodeteve dhe vëmë theksin tonë në bashkëpunimin me shoqëri të huaja, ti ftojme dhe tu krijojmë besim atyre për të investuar në shqipëri në fushën e ndërtimit.

Gjithashtu duhet të ngremë zërin për vendosjen e disa çmimeve taban, sa më afër tregut të punës në fushën e ndërtimit.

Por s'mund të lemë pa përmendur një problem që lidhet me kalibrimet e instrumentave. Për të dhënë rezultate sa më të mira, me një saktësi maksimale në matjet topografike duhet që instrumentat të kalibrohen sipas normave dhe afateve të përcaktuara. Këto janë disa nga pikat që shoqata duhet të fokusohet dhe të punojë në maksimum në qoftë se duam që ti japim një zhvillim cilsore dhe komodë fushës sonë në të mirë të punës së përbashkët dhe të ofrojmë shërbim sa me cilësor .

GJEOKONSULT & CO

Themeluan në vitin 2009 "GJEOKONSULT&CO" sjell risi të reja në fushën e konsulencës ndërtimore. Bashkëpunimi me shoqëri të huaja ka bërë të rritemi profesionalisht dhe të krijojmë besim te klientët. Me pajisje dixhitale, ide të reja dhe eksperiencë të shumta në fushën e ndërtimit ju ofrohemi si zgjidhja më e mirë në treg.

Çfarë Ofrojmë:

-Konsulencë ndërtimore dhe topografike për ndërtim në :

rrugë, ura, tynele, objekte civile, industrial e turistike.

-Hartim plane rregulluese, masterplane, studime urbanistike.

-Topografi nënujore, batimetri .

-Studime gjeologjiko-inxhinierike, prova laboratorike.

**Me punën tonë
fitojmë besimin tuaj**

ADRESA : Tiranë, Kashar, Kthesa e Kamzës,
Prane Spitalit Grek "HYGEIA"

NR.CEL : 067 20 64 635

067 20 36 620

TEL/FAX : +355 44 809 677

e-mail : gjeokonsult@hotmail.com

web: www.gjeokonsult.com



Bledi Stefa**Kryetar**

Përfundon studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi dhe menjëherë fillon punë në profesion pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Ka kryer studimet pas-universitare mbi Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme. Aktualisht punon pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit në sektorin e shpronësimeve. Njohës shumë i mirë i çështjes së pronës, anës teknike dhe legislative të saj.



sektorit të regjistrimit dhe hartografisë pranë Zvrpp-së Tiranë e më pas Inspektor pranë AKKP-së. Z. Nazarko gëzon një eksperiencë të madhe në çështjet e pronësisë.

Jak Suli**Anëtar i Këshillit Drejtues**

Ka përfunduar studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi dhe më pas ka kryer disa specializime të ndryshme profesionale. Z. Suli vjen nga një eksperiencë e gjatë profesionale dhe aktualisht është administrator i kompanisë private Geomatica Sh. p. k. Gëzon cilësinë e veçantë të trashëgimit të profesionit tek njerzit e familjes.

**Fatmir Ejupi****Nën Kryetar**

Ka përfunduar studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi. Ka kryer studimet pas-universitare mbi Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme si dhe për Testimin e Performances së Produkteve të Ndërtimit. Njohës i mirë i Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sistemeve GIS etj. Z. Ejupi prej vitesh ushtron profesionin e Gjeodetit si në sektorin privat ashtu edhe në Administratën Shtetërore. Propozohet dhe miratohet në mbledhjen e Kryesisë për të ushtruar detyrën e nën kryetarit të SH.GJ.SH.-së.

**Eriseld Hila****Anëtar i Këshillit Drejtues**

Kryen studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi. Z. Hila vjen me një eksperiencë të gjatë pune në fushën e pronësisë. Ka përfunduar kursin pas universitar të Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme njëherazi është Gjeodetë i Liçensuar.

**Lorenc Zani****Nën Kryetar**

Ka përfunduar studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi. Më pas ka kryer një sërë kualifikimesh pas universitare. Aktualisht e ushtron profesionin e tij në sektorin privat dhe është ndër biznesmenët Gjeodetë më të suksesshëm jo vetëm në tregun vendas. Z. Zani është administrator i përgjithshëm i kompanisë Lorenzo & Co.

**Anri Saja****Anëtar i Këshillit Drejtues**

Kryen studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi. Është një njohës i mirë i programeve profesionale dhe instrumentave gjeodezikë. Ushtronë detyrën e përgjegjës të sektorit në Komunën e Kasharit. Njohës i mirë i legjislacionit të çështjes së pronës dhe një profesionistë i arrirë.

**Xhevahir Mustafa****Anëtar i Këshillit Drejtues**

Kryen studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi. Shumë shpejt, fal aftësive profesionale e gjen veten në tregun privat dhe aktualisht është administrator i kompanisë private Gjeokon-sult & CO. Sh.p.k, kompani e cila renditet ndër më të suksesshmet në treg.

**Romeo Nazarko****Sekretar i Përgjithshëm**

Ka përfunduar studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi. Për një periudhë afatgjate ushtron detyrën e përgjegjës të



Alban Suku

Anëtar i Këshillit Drejtues

Vazhdon studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi, njëkohësisht studion edhe për drejtësi. Drejtues i strukturës Albanian Young Surveyors dhe përfaqësues i studentëve në Shoqatën e Gjeodetëve të Shqipërisë.



Edison Sinanaj

Anëtar i Këshillit Drejtues

Kryen studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi. Aktualisht ushtron profesionin e Gjeodetit në sektorin privat. Bisnesmen i suksesshem dhe administrator i kompanisë Gjeo-Sky Sh. p. k. Zotëron programe dhe instrumenta të ndryshëm profesional.



Kostandin Qirjazi

Anëtar i Këshillit Drejtues

Ka përfunduar Universitetin Ushtarak "Skënderbej", Dega Topografi. Zotëron një eksperiencë të gjatë profesionale Topografike dhe Gjeodezike si dhe gëzon vlera të trashëgimit të profesionit të Gjeodetit. Ndër të tjera, Z. Qirjazi ka një kontribut të veçantë në Shoqatën e Gjeodetëve të Shqipërisë.



Erbil Skuka

Anëtar i Këshillit Drejtues

Ka përfunduar studimet pranë FIN, Dega Gjeodezi. Z. Skuka përdorë një larmi të gjërë të programeve profesionale dhe instrumentave gjeodezike. Aktualisht është drejtues teknik pranë kompanisë private Gjeokonsult & CO. Sh.p.k.



VENDI I ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT: ROYAL MILITARY ACADEMY, BELGIUM

THE FIRST DAY OF THE EUROPEAN SURVEYORS DITA E PARË E GJEODETËVE TE EUROPËS

Në datën 5 Mars 2012, u festua në Bruksel Dita e Parë e Gjeodetëve Europës njëherazi edhe 500 vjetori i Merkatorit.

Me ftesë të Presidentit të Këshillit të Gjeodetëve të Europës (CLGE) Z. Jean-Yves Pirlot si dhe me mbështetjen e Unionit Belgë të Gjeodetëve të Monsit dhe në veçanti Drejtuesit të UGEM-it Z. Jonathan Albert, Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë mori pjesë në Ditën e Gjeodetëve të Europës si dhe në 500 vjetorin e Merkatorit.

Në këtë eveniment ishin të pranishëm personalitetet më të larta të Gjeodezisë Botërore. Mund të përmendim, Presidenti i CLGE Z. Jean-Yves Pirlot, njëherazi organizatori kryesor i eventit, Presidenti i FIG-ut Z. Teo CheeHai, Presidenti i EGoS-it Z. Randolph Camilleri, Drejtori Egzekutiv i “The European GNSS Agency”, një numër i konsideruar personalitetesh nga Belgjika, Franca, Italia, Greqia si dhe rreth 300 profesionist nga mbarë bota. Vendi Ynë përfaqësohej në këtë event, nga Z. Bledi Stefa Kryetar i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë si dhe Z. Alban Suku Drejtues i Strukturës Gjeodetët e së Ardhmes. Z. Stefa dhe Z. Suku shoqëroheshin prej Z. Jonathan Alber, President i Unionit Belgë të Gjeodetëve të Monsit, si dhe nga kolegë të tjerë Belgë.

Evenimente mbi Ditën e Gjeodetëve të Europës u mbajtën në pothuajse gjithë shtetet e tjera Europiane. Gjithashtu, SHGJH njoftoi të gjithë anëtarët e saj mbi këtë ditë të veçantë si dhe fal mbështetjes së Presidentit



të CLGE Z. Jean-Yves Pirlot dhe Kolegut Jonathan Albert, 2 përfaqësues nga Gjeodetët Shqipëtar ishin pjesë e eventit special mbajtur në Bruksel.

Në mbyllje të eventit, CLGE, Presidenti Jean-Yves Pirlot në bashkëpunim edhe me Royal Military Academy kishin organizuar një darkë gala për të pranishmit.



FENO

The permanent survey marker

Designed in 1970,
The FENO Survey marker remains a
unique concept:

- The « polyroc » marker's head is built out of a secret concrete mix, harder than granite.
- The hot dip galvanized anchor is installed with a minimum effort in few minutes and offers an unbelievable uprooting resistance.

Exported all around the world "The unique FENO CONCEPT" is offered with a large range of topographical accessories for setting up, referencing and transporting.



More than 30 references
of Survey marker's head

Patented locking sleeve

3 standard lengths of
anchorage

3 strong extendable
steel flukes

Underground reference mark

Colored survey nail and colored identity disk for
underground networks markings. Available in
various colours and possibility to engrave
desired information such as text, logos or a
logical series of numbers



Bornes FENO-Société Faynot
BP13 - F-Thilay
Tél : 00(33) 3 24 33 70 70 - Fax : 00(33) 3 24 32 84 93
www.faynot.com - contact@faynot.com



TRIMBLE

